- Formulimin e rekomandimeve të qarta për krijimin dhe fuqizimin e sistemeve kombëtare dhe rajonale të informacionit mbi drogat, përfshirë caktimin e pikave fokale kombëtare.
- Bashkëpunimin me shërbimet e Komisionit dhe delegacionet e BE për të siguruar mbështetjen e plotë të autoriteteve kombëtare nga projekti.

Me fillimin e projektit të CARDS, EMCDDA ndërmori një vlerësim tërësor të nevojave në secilin nga vendet përfituese. Ajo gjithashtu prezantoi informacione mbi rolin dhe aktivitetet e saj, në kuadër të Strategjisë dhe Planit të Veprimit të BE kundër Drogës, duke u fokusuar në rrjetin Reitox, indikatorët kryesorë epidemiologjikë si dhe grupe të tjera të dhënash. Gjatë vizitave në vendet përkatëse u vlerësuan

nevojat specifike të vendit përmes identifikimit dhe krijimit të hartave mbi burimet ekzistuese të informacionit dhe ekspertizës për drogat e paligjshme. Vlerësimet e nevojave krijuan gjithashtu harta për aktivitetet kombëtare të lidhura me projekte që parashikohen të zbatohen në shkallë vendi, gjatë jetëgjatësisë së projektit të CARDS.

Projekti i CARDS gjithashtu mbështeti realizimin e studimeve në shkollë, të cilët janë plotësisht në përputhje me metodologjinë e zhvilluar në nivel evropian, nga Projekti i Studimit të Shkollave Europiane për Alkoolin dhe Drogat e tjera (ESPAD). Qëllimi i përgjithshëm i studimeve të ESPAD është të studiojë përdorimin e substancave nga adoleshëntët në Europë nga perspektiva krahasuese dhe longitudinale. Synimi kryesor i tyre është të grumbullojë të dhëna ta krahasueshme mbi përdorimin e alkoolit, duhanit dhe drogave të tjera nga studentët në vendet e Europës, vendet kandidatë, apo vendet e mundshme kandidatë. Synohet që studimet të përsëriten çdo katër vjet.

Për të ndihmuar vendet partnere në hartimin e një vështrimi për vendin, në Beograd në Tetor 2008 u organizua një seksion trajnimi akademik nga Reitox dhe u krijuan grupet e punës. Këto grupe, kanë përdorur informacionet ekzistuese në nivel kombëtar për të hartuar vështrimet mbi vendin, të cilat sigurojnë një përmbledhje të strukturuar të tendencave dhe karakteristikave të problematikave të drogës në secilin nga vendet.

Grupi i punës i Raportit të Përgjithshëm për Vendin

Eduard Kakarriqi, MD, MSc, PhD, Profesor
Korrespondent Kombëtar për CARDS, Shef i Departamentit të Epidemiologjisë, Indikatorëve Shëndetësorë dhe Politikave Shëndetësore, Instituti i Shëndetit Publik

Alban Ylli, MD, MPH, PhD
Drejtor, Instituti i Shëndetit Publik

Zihni Sulaj, MD, PhD, Profesor i Asocijuar
Shef i Shërbimit të Toksikologjisë Klinike, Qendra Spitalore Universitare 'Nënë Tereza' në Tiranë

Silva Bino, MD, MPhil, PhD, Professore e Asocijuar
Shefe e Departamentit të Kontrollit të Sëmundjeve Infektive, Instituti i Shëndetit Publik

Sokol Selfollari
Shef i Njësisë Anti-drogë, Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ministria e Brendshme

Nën supërvizimin e:

Neoklis Georgiades
Drejtor i Qendrës Qipriote të Monitorimit për Drogat dhe Varësinë nga Droga; instruktor i CARDS Reitox për Shqipërinë

Katalin Felvinczi, MD
Drejtor i Institutit Kombëtar për Prandalimin e Drogës, Hungari; supërvizor i CARDS

Vlera kyç

	Viti	Shqipëria	BE (27 vende)	Burimi
Sipërfaqja	2008	28 748 km ²	4 200 000 km ²	CIA – The World Factbook
Popullsia	2008	3 100 000	499 794 855 ⁽⁶⁾	Eurostat
GDP për frymë në PPS (Standarde të Fuqisë Blerëse, Purchasing Power Standards) ⁽¹⁾	2006	21	100	Eurostat
Pabarazia e shpërndarjes së të ardhurave ⁽²⁾	2008	N/A	100	Eurostat
Niveli i Papunësisë ⁽³⁾	2006	13.8 %	7,0 % ⁽⁴⁾	Eurostat
Niveli i Popullsisë në Burgje ⁽⁵⁾	2006	122.4		Council of Europe, SPACE 2006. 1

⁽¹⁾ Produkti i brendshëm bruto (GDP) mat aktivitetin ekonomik. Ai përcaktohet si vlera e të gjitha të mirave dhe shërbimeve të prodhuara minus vlerën e të mirave dhe shërbimeve të përdorura për krijimin e tyre. Volumi i indeksit të GDP për frymë në Standarde të Fuqisë Blerëse është shprehur në lidhje me mesataren e Bashkimit Europian (BE-27), e vendosur në masën 100. Nëse indeksi i një vendi është më shumë se 100, niveli i GDP për frymë në këtë vend është më i lartë se mesatarja e BE dhe anasjelltas.

⁽²⁾ Pabarazia në shpërndarjen e të ardhurave matet si raporti i të ardhurave totale të grumbulluara nga 20% e popullsisë me të ardhurat më të larta (kuintili i sipërm) me të ardhurat totale të 20 % të popullsisë me të ardhurat më të ulëta (kuintili i poshtëm).

⁽³⁾ Niveli i papunësisë përfaqëson numrin e personave të papunë si përqindje e forcës së punës. Personat e papunë përfshijnë individët e moshës 15-74 vjeç, të cilët: (a) ishin pa punë gjatë javës referuese; (b) aktualisht të gatshëm për punë; (c) që kërkojnë punë në mënyrë aktive.

⁽⁴⁾ Shifra të 2008-s.

⁽⁵⁾ Situata e institucioneve penale më 1 Shtator 2006. Niveli i popullsisë në burgje për 100 000 banorë.

⁽⁶⁾ Shifra të 2009-s.

Republika e Shqipërisë është një ndër vendet e Ballkanit Perëndimor në Europën Jug-lindore, që kufizohet me Italinë nëpërmjet Detit Adriatik dhe Jon në perëndim, me Greqinë në jug dhe jug-lindje, me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë në jug-lindje, me Kosovën në veri dhe në veri-lindje dhe me Malin e Zi në veri dhe veri-perëndim. Sipas Librit Botëror të Fakteve / World Factbook, popullsia e Shqipërisë përbëhet nga 95 % shqiptarë, 3 % grekë dhe 2 % të ndryshëm (vllh/arumunë, Romë, jevgj [egjyptianë], serbë, maqedonas dhe bullgarë). Gjuha shqipe është gjuha zyrtare. Kryeqyteti i vendit është Tirana me më shumë se 800 000 banorë. Qytetet kryesore të mëdha janë Durrësi, Shkodra, Vlora, Elbasani, Berati dhe Korça. Tabela e mësipërme ofron të dhëna të rëndësishme socio-demografike rreth vendit.

Përdorimi i drogës në popullatën e përgjithshme dhe të rinjtë

Deri tani nuk është realizuar ndonjë studim për përdorimin e drogës nga popullsia e përgjithshme. Megjithatë, numri i përgjithshëm i të rriturve (15-64 vjeç), të cilët kanë provuar lloje të drogave të paligjshme, është vlerësuar rreth 5 000 në vitin 1995 (prevalenca jetësore 0.2 %) dhe 20 000 në vitin 1998 (prevalenca jetësore 1.0 %), (Kakarriqi dhe Sulaj, 200b), ndërsa shifrat aktuale luhaten ndërmjet 40 000 dhe 60 000 (prevalenca jetësore ndërmjet 2.0 % dhe 2.8 %), çka tregon për një rritje e konsiderueshme që nga viti 1995. Duhet theksuar se këto shifra janë vlerësime të ofruara nga ekspertët vendas.

Të dhëna mbi prevalencën jetësore të disa drogave të paligjshme gjenden në Studimin mbi Sjelljet e Rrezikshme të të Rinjve, (SSRrR), (Instituti i Shëndetit Publik, Shqipëri, 2006). Ky studim, realizuar nga Instituti i Shëndetit Publik më 2005, fokusohet në popullatën e shkollave të mesme dhe ka një masë kampioni (madhësi zgjedhje) rreth 4 000 pjesëmarrës. Variabli i SSRrR mbi prevalencën jetësore të përdorimit të drogës përputhet me përkufizimin e rastit sipas EMCDDA. Studimi tregoi se 5,4 % e personave të moshës 14-18 vjeç kanë eksperimentuar me kanabis dhe 4 % me ekstazi; 1,4 % kishin përdorur heroinë, dhe 1,6 % kishin përdorur kokainë. Prevalenca jetësore e përdorimit të drogave të paligjshme ishte pak më e lartë në kryeqytet, krahasuar me pjesën tjetër të vendit dhe ishte disa herë më

e lartë për meshkujt se sa për femrat. Droga të paligjshme u qenë ofruar më shumë se 9 % të personave që u përgjigjen, kur kanë qenë në mjedise të shkollës.

Instituti i Shëndetit Publik po planifikon një studim të ngjashëm në mbarë vendin për Sjelljet e Rrezikshme të të Rinjve për vitin 2009. Rezultatet e një studimi të bazuar në shkollë mbi përdorimin e drogës, realizuar kohët e fundit nga Instituti i Studimeve të Opinioneve Publik (ISOP), një OJF shqiptare, ende nuk janë bërë publike. Studime të tjera të bazuara në shkollë, realizuar nga Drejtoria Arsimore e Kurrikulave në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, nuk janë në shkallë vendi, nuk kanë përdorur instrumenta epidemiologjikë të matshëm dhe pohojnë se ofrojnë vetëm të dhëna cilësore (kualitative).

Në Shqipëri, deri tani nuk është kryer ndonjë studim ESPAD.

Parandalimi

Rëndësia e parandalimit të drogës në Shqipëri është pasqyruar në miratimin e Strategjisë Kombëtare kundër Drogave 2004–10. Strategjia përfshin objektiva dhe masa të orientuara kah reduktimin të kërkesës për drogë dhe kontrollit të ofertës njëkohësisht. Megjithatë, masat në lidhje me parandalimin kanë qenë spontane dhe të pakoordinuara.

Puna e hershme për parandalimin e drogës filloi në fund të viteve 1990, kryesisht e mbështetur nga donatorë të huaj, përfshirë Këshillin e Evropës, Fondin e Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA), UNICEF, Fondacionin Soros, etj. Ndërhyrjet kanë zhvilluar aftësi të stilit të jetesës përmes ofrimit të materialeve ekstrakurrikulare për shkollat dhe trajnime për mësuesit, përfaqësuesit e medias dhe bashkë-moshatarët. Ndërgjegjësimi i komunitetit për rreziqet që drogat paraqesin për individët dhe familjet është rritur nëpërmjet programeve televizive, spoteve në media, posterave, fletëpalosjeve dhe aktiviteteve të tjera.

Mbështetur nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), UNFPA drejtoi një projekt tre-vjeçar (filluar më 2005), të quajtur 'Mbështetje për Edukimin e Stileve të Shëndetshme të Jetesës tek të Rinjtë në Shqipëri', i cili u fokusua në përmirësimin e njohurive mbi shëndetin seksual dhe riprodhues të adoleshentëve, parandalimin e sjelljeve të rrezikshme dhe përdorimin e drogave intravenoze (IDU), ngritjen e kapaciteteve të ofruesëve të kujdesit shëndetësor, si edhe përmirësimin e kurrikulës së edukimit shëndetësor (në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës) (UNFPA, 2008). Projekti, me OJF rinore, ka arritur afërsisht 35 000 të rinj (të moshës 15–19 vjeç) në shkollë kombëtare përmes edukimit të bashkë-moshatarëve; ka krijuar gjithashtu një rrjet me 154 persona të përgatitur për edukimin e bashkë-moshatarëve si dhe tetë trajnerë (ToTs) në edukimin e bashkë-moshatarëve. Projekti është

në vazhdim (që nga 2008) dhe po zbatohet në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Fokusi kryesor i programit mbetet mbështetja e stileve të shëndetshme të jetesës në të rinjtë shqiptarë.

Në vitin 2008, Nën-komisioni Parlamentar Shqiptar për Mbrojtjen Sociale, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, UNICEF, UNFPA, Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Rrjetin e të Rinjve Shqiptarë për Integrimin Evropian dhe parlamentet rinore, nisi fushatën kombëtare "Jeto shëndetshëm". Qëllimi i fushatës është të rrisë ndërgjegjësimin mes adoleshentëve rreth rëndësisë së stileve të shëndetshme të jetesës. Ndërgjegjësimi mbi drogat është një nga komponentët e fushatës. Fatkeqësisht nuk ka informacion të mëtejshëm rreth metodologjisë.

Gjatë vitit 2008, Instituti i Shëndetit Publik identifikoi nevojën për parandalimin e abuzimit me substancat në disa rrethe të vendit dhe e adresoi atë duke trajnuar aktorët e duhur.

Disa nga aktivitetet parandaluese realizohen kryesisht nga OJF-të. Tre OJF, (Aksion Plus, Stop AIDS dhe APRAD) kanë ofruar disa ndërhyrje parandaluese së bashku me programe të reduktimit të dëmit, duke targetuar (shënjuar) grupet me rrezikshmëri të lartë siç janë nxënësit që braktisin shkollën, ata që mbetet në klasë, etj. Përqajet/metodat e përdorura përfshijnë leksione, diskutime në grup dhe prezantime të konkluzioneve të ushtrimeve të realizuara nga grupi. Aksion Plus, Stop AIDS dhe APRAD kanë raportuar në Institutin e Shëndetit Publik se kanë regjistruar në çdo vit një numër të përgjithshëm prej 800–850 pjesëmarrësish në programet e tyre që nga viti 2004 e në vazhdim.

Në vitin 2006, Ministria e Arsimit dhe Shkencës prezantoi shërbimet psikologjike në mjediset e shkollës, por përdorimi i tyre mbetet rastësor dhe nuk ka tregues të ndërhyrjeve parandaluese të dokumentuara, veçanërisht të targetuara (shënjuara) tek individët që shfaqin shenja të hershme të abuzimit me substancat dhe probleme të tjera të sjelljes.

Në vitin 2008, Ministria e Shëndetësisë rishikoi paketën e shërbimeve të ofruara nga shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor dhe përfshiu këshillimin për parandalimin e drogës për pacientët dhe komunitetin.

Përdorimi problematik i drogës

Deri tani nuk ka një regjistër kombëtar për përdoruesit problematikë të drogës. Numri i përdoruesëve problematikë të drogës në vend vlerësohet të jetë 4 500–5 000 persona; megjithatë, duhet theksuar se kjo shifër është thjesht një vlerësim, bazuar në opinionin e ekspertëve vendas. Mungesa e të dhënave të besueshme vjen si rezultat i vështirësive në bashkërendim dhe bashkëpunim ndërmjet tërë aktorëve

përkatës dhe mungesës së ekspertizës në vlerësimin e përdorimit problematik të drogës.

‘Përdorimi problematik i drogës’ është përcaktuar nga EMCDDA si përdorimi intravenoz i drogës ose përdorimi afatgjatë ose i rregullt i opiateve, kokainës dhe/ose amfetaminës; ekstazia dhe kanabis nuk janë të përfshira në këtë kategori.

Kërkesa për trajtim

Ekziston vetëm një qendër e specializuar për drogën në Shqipëri, Shërbimi i Toksikologjisë Klinike në Qendrën Spitalore Universitare ‘Nënë Tereza’ në Tiranë (QSUT). Kjo është një qendër publike, përgjegjëse për të gjithë vendin dhe që trajton kryesisht detoksifikimin dhe rastet me mbidozë. Ajo shërben njëkohësisht si njësi spitalore me shtretër edhe për trajtimin e pacientëve të jashtëm dhe është burimi kryesor i të dhënave për kërkesën për trajtim.

Ekzistojnë edhe dy qendra të tjera trajtimi, të cilat janë private, — Emanuel, një qendër trajtimi terapeutik e ngritur nga një OJF, që ofron trajtim rezidencial, dhe Aksion Plus, një OJF tjetër, e cila ofron trajtim zëvendësues me metadon. Klientët vijnë nga ose janë të referuar në Shërbimin e Toksikologjisë Klinike. Por mungon shkëmbimi i duhur i të dhënave ndërmjet tyre, sepse Qendra Kombëtare për Sistemin e Informacionit mbi Drogën në Institutin e Shëndetit Publik, e cila duhet të ofrojë sistemet e nevojshme për të hyrë në bazën e të dhënave, nuk e ka realizuar këtë funksion dhe Ministria e Shëndetësisë nuk ka ndërtuar një mekanizëm koordinimi ndërmjet këtyre institucioneve.

Të dhënat e ofruara nga Shërbimi i Toksikologjisë Klinike në QSUT që nga 1995 e në vazhdim tregojnë tendencat në ecurinë e kohës e kohës. Numri total i kërkesave për trajtim (ose numri i vizitave për trajtim) në Shërbimin e Toksikologjisë Klinike është rritur në mënyrë të ndjeshme, nga 672 raste në vitin 2000 në 1 057 raste në vitin 2001 dhe 1 702 në vitin 2002, duke qëndruar pothuajse konstant në vitet në vazhdim me 1 855 (2003), 1 805 (2004) dhe 1 735 raste (2005), me një rritje të mëtejshme në mbi 2 000 vizita trajtimi në vit më 2006 (2 352) dhe 2007 (2 070).

Në vitin 2007, Shërbimi i Toksikologjisë Klinike ⁽¹⁾ regjistroi 108 klientë të rinj (ose për herë të parë), (FTD – First Treatment Demand) ⁽²⁾ që filluan trajtim (në përputhje me Protokollin Standard 2 të TDI – Treatment Demand Indicator), nga totali

856 i të gjitha kërkesave për trajtim (ATD – All Treatment Demand), ndërsa 3.6 % u referuan nga agjensitë e kujdesit shëndetësor, policia dhe burgjet. 781 klientë (apo 91.2 %) nga totali prej 856 ATD ishin përdorues problematikë të drogës ⁽³⁾. Ata ishin pothuaj nga të gjitha rajonet e Shqipërisë; megjithatë, shumica (rreth 70 %) ishin nga Tirana dhe rajonet/zonat qendore dhe qendore-perëndimore.

Mosha mesatare e të gjithë klientëve që fillonin trajtimin ishte 25,9 vjeç, duke filluar nga ≤15 vjeç (1,4 %) deri në ≥40 vjeç (0,7 %); grupmosha 21–30 vjeç përbënte 75 % të numrit total të klientëve. Diferencë në shpërndarjen moshore u raportua mes klientëve të rinj në trajtim, me moshë mesatare 19,9 vjeç ose 6 vjeç më të rinj se sa mosha mesatare e të gjithë klientëve që fillonin trajtimin. Kohëzgjatja totale e përdorimit të drogave të paligjshme ishte 5,5 vjet. Nga të gjithë klientët e regjistruar, 95,6 % ishin meshkuj dhe 4,4 % ishin femra.

Lidhur me llojin e drogave të përdorura nga klientët që fillonin trajtimin, opiatet (kryesisht heroina) ishin më të raportuarat, në masën 71,0 %, të ndjekura nga THC me 5,6 %, kokaina me 2,2 %, dhe benzodiazepinat me 0,2 %. Rreth 20,9 % e klientëve raportuan përdorimin e më shumë se një droge, dhe 86 % e tyre ishin përdorues të disa drogave opioide. Nga klientët e rinj që fillonin trajtimin, 72,3 % raportuan heroinën si drogën e tyre kryesore; vlen të nënvizohet se 19,3 % e tyre ishin të moshës ≤15 vjeç dhe 48,1 % të moshës 16–20 vjeç.

Përsa i përket rrugës apo mënyrës së marrjes së drogave, 41,7 % e klientëve i merrnin drogat me injeksion intravenoz, 49,4 % nëpërmjet tymosjes ose thithjes me hundë, ndërsa për pjesën tjetër nuk kishte informacion. Rreth 10,5 % e klientëve i përkisnin diagnozës së dyfishtë, dmth çrregullime psikike dhe probleme nga përdorimi i drogës.

Sëmundje infektive të lidhura me drogën

Të dhënat për sëmundjet infektive të lidhura me drogën në Shqipëri vijnë kryesisht nga survejimet laboratorike të survejancës mbi HIV/AIDS, hepatitin viral dhe infeksionet seksualisht të transmetueshme (IST) (Laboratori Kombëtar i Referencës për HIV dhe Hepatitin Viral dhe Programi Kombëtar i HIV/AIDS/IST nën Departamentin e Kontrollit të Sëmundjeve Infektive në Institutin e Shëndetit Publik) ⁽⁴⁾,

⁽¹⁾ Regjistri i Kërkesës për Trajtim i Shërbimit të Toksikologjisë Klinike në Qendrën Spitalore Universitare ‘Nënë Tereza’ të Tiranës - QSUT, (shih Raportin e “Hartës së Informacionit për Drogën” dhe Anekset).

⁽²⁾ Përdoruesit e drogës që kërkojnë ndihmë për probleme të lidhura me drogën janë klientë të Shërbimit të Toksikologjisë Klinike; shumica e tyre janë përdorues problematikë të drogës.

⁽³⁾ Përdorues problematikë të drogës janë përdoruesit e drogave me injeksion ose përdoruesit afatgjatë/të rregullt të opiateve, kokainës dhe amfetaminës.

⁽⁴⁾ Regjistri i Sëmundjeve Infektive të Lidhura me Drogën i Departamentit të Kontrollit të Sëmundjeve Infektive, Instituti i Shëndetit Publik (shih Raportin e “Hartës së Informacionit për Drogën” dhe Anekset).

Survejmimi i Survejanca Biologjike dhe të Sjelljes (Bio-BSS), realizuar më 2005 (Instituti i Shëndetit Publik, USAID, FHI dhe ISOP, 2006), dhe survejanca sentinel e OJF-ve të ndryshme që punojnë në fushën e reduktimit të dëmit nga droga. Duhet theksuar se të dhënat e Institutit të Shëndetit Publik për sëmundjet infektive të lidhura me drogën mbulojnë të gjitha agjensitë përkatëse (institucionet shëndetësore publike dhe private, OJF-të e përfshira, etj.) në të gjithë territorin e vendit.

Të dhënat nga Bio-BSS (realizuar në Shqipëri në vitin 2005) nuk treguan përdorues të drogave me injeksion (IDU) të infektuar me HIV, nga kampioni me 224 persona. IDU-të përbëjnë vetëm 1 % të të infektuarve me HIV në totalin kumulativ prej 291 raste të regjistruara nga survejanca e HIV në popullatën e përgjithshme që nga viti 1993 (vit kur u zbulua rasti i parë me HIV në Shqipëri). Të dhënat nga survejanca sentinel e OJF-ve, po ashtu nuk treguan për raste me HIV në IDU-të.

Prevalenca e Hepatitit viral akut B në IDU-të në gjetjet e Bio-BSS 2005 ishte 12,5 % (28/224) (95 % CI: 7,9–21,3 %). Të dhënat nga studimet laboratorike të Hepatitit B në IDU-të më 2003 dhe 2006–07 demonstuan një prevalencë të HBsAg+ në përkatësisht 10,1 % dhe 22,8 %. Duhet theksuar se Shqipëria është ende vend me prevalencë të lartë deri mesatare të Hepatitit viral B (6 % e deri më shumë se 8 %) në popullatën e përgjithshme, megjithë programin e vaksinimit specifik të detyrueshëm kundër këtij infeksioni për të gjithë të posalindurit dhe foshnjat qysh prej vitit 1995. Prevalenca e Hepatitit viral akut B është rritur me kalimin e viteve në IDU-të, çka tregon për qarkullim të lartë të tij në këto grupe me risk-të-lartë, vecanërisht kur krahasohet me popullatën e përgjithshme.

Prevalenca e Hepatitit C është ende e ulët në popullatën e përgjithshme: 0,99–1,2 %, bazuar në survejancën laboratorike të hepatitit. Në vitin 2005, të dhënat nga Bio-BSS 2005 treguan një prevalencë të hepatitit C në IDU-të në nivelin 26,7 % (60/224) (95 % CI: 11,0–25,7 %). Të dhënat nga survejimet laboratorike të hepatitit C në IDU-të më 2003 dhe 2006–07 treguan një prevalencë në nivelet përkatësisht 12,6 % (8/63) dhe 29,4 % (48/163). Prevalenca e Hepatitit C është rritur me kalimin e viteve dhe tregon qarkullim të lartë mes përdoruesve të drogës, veçanërisht kur krahasohet me popullatën e përgjithshme.

Prevalenca e Sifilizit më 2005 ishte 1,3 % (3/224) (95 % CI: 0,3–2,3 %) në IDU-të, krahasuar me 0,2 % prevalencë (2/629) në popullatën e përgjithshme.

Vdekjet nga droga

Në Shqipëri nuk ka të dhëna të besueshme për vdekjet nga droga. Informacioni zyrtar për vdekjet nga droga është i dobët, madje virtualisht jo ekzistues, për disa arsye: (1) Ka mungesë ndërgjegjësimi profesional në stafin mjekësor për vdekjet nga

droga, dhe si pasojë, një vdekje e shkaktuar nga mbidoza e drogës diagnostikohet në rutinë si atak/pushim zemre. (2.) Ka mungesë bashkëpunimi dhe bashkërendimi mes agjensive përkatëse dhe ndër-shkëmbimi i të dhënave është i pakët. (3.) Megjithëse Laboratori Toksikologjik i Institutit të Mjekësisë Ligjore është plotësisht i aftë të realizojë konfirmimin e vdekjeve nga droga, ka mungesë informacioni dhe ndërgjegjësimi për ekzistencën e një agjencie të tillë të kualifikuar. (4.) Për më tepër, analizat e lëngjeve të trupave nga vdekjet toksikologjike janë shumë të rralla, për arsye të pranishme ende të theksuar të stigmës lidhur me dukurinë (fenomenin) e drogës, për çka, Instituti i Mjekësisë Ligjore nuk është i autorizuar të realizojë autopsinë nëse nuk i kërkohet një gjë e tillë (nga familjarët e viktimës).

Shërbimi i Toksikologjisë Klinike në Qendrën Spitalore Universitare 'Nënë Tereza' të Tiranës (QSUT) raportoi katër vdekje nga droga për periudhën 2005–08, të regjistruara në Departamentin e Shërbimit të Urgjencës të QSUT. Megjithatë, këto raste ishin të regjistruara vetëm si 'raste të dyshuara klinikisht' të shkaktuara nga mbidoza të heroinës, për arsye se autopsitë u refuzuan nga familjarët/të afërmit përkatës dhe nuk ishin të konfirmuara nga Laboratori Toksikologjik ose Instituti i Mjekësisë Ligjore. Në një të tillë situatë, funksionimi dhe forcimi i informacionit për vdekjet nga droga në Shqipëri është problem shqetësues dhe në nevojë urgjente për zgjidhje.

Programet (përgjigjet) e trajtimit

Mundësitë e trajtimit në Shqipëri janë mjaft të kufizuara dhe fokusi kryesor konsiston në trajtimin zëvendësues (metadon) dhe reduktimin e dëmit. Trajtimi me buprenorfinë nuk është akoma i disponueshëm. Ministria e Shëndetësisë nuk ka alokuar ende fonde të veçanta në buxhetin e saj për shërbimet e trajtimit nga droga. Trajtimi detoksifikues, përfshirë medikamentet bazë të domosdoshme, nuk financohet nga agjensia kombetare e sigurimeve shëndetësore. Ndërhyrjet psikosociale shpesh mungojnë. Trajtimi i përdoruesve problematikë të drogës (PDU-ve) mbetet ende jashtë fokusit të shërbimeve të përgjithshme shëndetësore; mjekët e përgjithshëm (mjekët e familjes), domethënë shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor, nuk janë të familjarizuar më këtë lloj ndërhyrjeje. Shërbimet sociale publike nuk janë ende të qarta rreth rolit dhe aktivitetit të tyre në fushën e trajtimit nga droga. Ndërkaq, sektori privat nuk është ende i përfshirë.

Ekziston vetëm një qendër publike e kualifikuar për trajtimin e PDU-ve, pikërisht Shërbimi i Toksikologjisë Klinike në Qendrën Spitalore Universitare 'Nënë Tereza' të Tiranës (QSUT); ai Shërbim ka 15 shtretër, mbulon të gjithë vendin dhe merret kryesisht me detoksifikimin dhe trajtimin e mbidozës, si dhe shërben si njësi spitalore me shtretër edhe për trajtimin e pacientëve të jashtëm. Shërbimet psikiatrike nuk ofrojnë trajtim për PDU-të, përveç rasteve me diagnozë të

dyfishtë (probleme psikiatrike dhe problemet nga përdorimi i drogës). Qendra terapeutike e komunitetit Emanuel, një OJF, ka rreth 20 shtretër dhe nuk përfaqëson një shërbim real të rehabilitimit multidisiplinar.

Trajtimi me metadon u vu në jetë në vitin 2005 nga OJF-ja Aksion Plus me financim nga Fondacioni Soros. Numri i përgjithshëm i klientëve që filluan këtë trajtim falas me metadon si pacientë të jashtëm, nga qershori 2005 deri në fund të vitit 2007, ishte 255 klientë PDU, duke përfshirë edhe të burgosurit. (në përputhje me një marrëveshje të firmosur me Ministrinë e Drejtësisë) ⁽⁹⁾. Vazhdimësia e programit (2008 e pas) si shërbim falas është siguruar nga mbështetja financiare e Fondit Global për HIV/AIDS. Trajtimi me metadon i ofruar nga Shërbimi i Toksikologjisë Klinike në QSUT nuk është falas dhe nuk rimburohet nga agjencia kombëtare e sigurimeve shëndetësore.

Sipas Strategjisë Kombëtare kundër Drogës 2004–10 (konkretisht komponentit të saj për Reduktimin e Kërkesës për Drogë në shkallë Vendi): (a) programet e trajtimit me metadon (zëvendësimi afat-gjatë) duhet të mbulojnë nga qendra të specializuara; (b) lëshimi i recetave mjekësore në periudhën e parë nuk duhet të shtrihet tek mjekët e familjes; (c) duhet të zbatohet një kërkesë rigorozë për trajnim të specializuar për mjekët që lëshojnë recetën; dhe (d) trajtimi me metadon ka nevojë për një metodologji dhe jo legjislacion të veçantë. Politika aktuale e trajtimit zëvendësues me metadon në Shqipëri duhet rrjedhimisht të ndjekë si logjikë përfaqëset e mësipërme.

Programet (përgjigjet) e reduktimit të dëmit

Në Shqipëri, programet e reduktimit të dëmit kanë filluar në vitin 1995. Ato aktualisht ofrohen nga tri OJF (Aksion Plus, APRAD, dhe Stop AIDS), të cilat punojnë në fushën e reduktimit të kërkesës për drogë dhe parandalimin e HIV/AIDS, me fokus të qartë në aktivitetet e reduktimit të dëmit, si dhe nga Qendrat publike të Testimit dhe Këshillimit Vullnetar të Programit Kombëtar të HIV/AIDS/IST. Përgjigjet e reduktimit të dëmit janë të fokusuar në shkëmbimin e ageve/shiringave, edukimin e bashkë-moshatarëve dhe informimin, këshillimin dhe mbështetjen psikosociale për personat e infektuar me HIV/hepatit viral. Shërbimet ofrohen kryesisht në kryeqytetin Tiranë, me një shpërndarje ende të pamjaftueshme në të gjithë vendin. Një ekip i lëvizshëm në Tiranë, i cili ofrohet nga OJF-ja Stop AIDS, arrin (kontakton) përdoruesit intravenozë të drogave (IDU-të) dhe grupe të tjera

në-risk-të-lartë në mjediset e tyre kryesore të takimeve. Përmes programeve të tilla, IDU-të jo vetëm shkëmbejnë age dhe shiringa, por marrin gjithashtu prezervativë, dezinfektantë, informacion dhe materiale edukuese, si dhe ndihmë sociale dhe psikologjike. Vlerësohet se deri tani rreth 1 800 IDU kanë përfituar nga programet e shkëmbimit të shiringave. Stop AIDS gjithashtu ofron aktivitete të reduktimit të dëmit për të burgosurit në pesë burgje, duke u fokusuar në informacion, këshillim, edukim të bashkë-moshatarëve, trajnimin e personelit mjekësor dhe atij psikosocial, testimin për HIV dhe hepatit B dhe C, si dhe ofrimin e prezervativëve.

Dënimet lidhur me drogën dhe tregtimin e saj

Sektori Anti-drogë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në Ministrinë e Brendshme, është organi kombëtar përgjegjës për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave dhe për prodhimin e statistikave kombëtare për dënimet lidhur me drogën dhe tregtimin e saj. ⁽⁹⁾ Në këtë kuadër, policia kufitare dhe ajo doganore kanë për detyrë zbatimin e ligjit për drogën, dhe në rast të arrestimeve dhe konfiskimeve ato janë të detyruara të përcjellin të dhënat në Sektorin Anti-drogë të lartpërmendur.

Kanabis është e vetmja bimë narkotike që kultivohet në Shqipëri. Gjatë periudhës 1993–2000 kultivimi i kanabis ishte i shtrirë në shumicën e territorit të vendit; ndërkohë që aktualisht ai është i lokalizuar në vetëm disa zona të vogla. Sipas Policisë së Shtetit:

- më 2005, ishin 458 raste të kultivimit të kanabis, 332 186 rrënjë të shkatërruara dhe 227 shkelës të ligjit të ndjekut penalisht;
- më 2006, ishin 145 raste të kultivimit të kanabis, 74 052 rrënjë të shkatërruara dhe 56 shkelës të ligjit të ndjekut penalisht;
- më 2007, ishin 271 raste të kultivimit të kanabis, 177 074 rrënjë të shkatërruara dhe 84 shkelës të ligjit të ndjekut penalisht.

Megjithëse në përgjithësi numrat janë ulur në mënyrë të konsiderueshme, Shqipëria mbetet një vend origjine për kanabisin dhe nën-produktet e tij (marijuanë, hashash, vaj hashashi). Greqia dhe Italia janë destinacionet kryesore për marijuanë dhe hashash, por një pjesë dërgohet edhe në vende të tjera të Evropës. Marijuana trafikohet kryesisht përmes ‘kufijve të gjelbër’ (pikat e paligjshme të kalimit të

⁽⁹⁾ Regjistri i OJF “Aksion Plus” për Trajtimin Zëvendësues me Metadon (shih Raportin e “Hartës së Informacionit për Drogën” dhe Aneksin).

⁽⁹⁾ Regjistri i Sektorit Anti-drogë për Konfiskimin e Drogave dhe Shkelësve të Ligjit për Drogën, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë (shih Raportin e “Hartës së Informacionit për Drogën” dhe Aneksin).

kufirit) të vendit. Çmimet në nivel rruge janë ngritur dhe më 2008 cmimi për 5 gram marijuanë varionte nga 4 deri në 8 Euro. Përqindja e THC në nivel rruge është rreth 4 %.

Duke qenë pjesë e krahut jugor të 'Rrugës Ballkanike', Shqipëria është vend tranzit për trafikimin e heroinës. Edhe pse numri i konfiskimeve dhe arrestimeve të personave është rritur nga viti në vit, trafikimi i heroinës mbetet një nga problemet më të mëdha. Sipas Policisë së Shtetit:

- më 2005, ishin 67 konfiskime heroine, ku u kapën 41,9 kg heroinë dhe 116 shkelës të ligjit u ndoqën penalisht;
- më 2006, ishin 90 konfiskime heroine, ku u kapën 120 kg heroinë dhe 169 shkelës të ligjit u ndoqën penalisht;
- më 2007, ishin 97 konfiskime heroine, ku u kapën 126,8 kg heroinë dhe 171 shkelës të ligjit u ndoqën penalisht.

Rrugët kryesore të tranzitit janë Turqi–Bullgari–Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë–Shqipëri ose Turqi–Bullgari–Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë–Kosovë–Shqipëri. Greqia dhe Italia janë destinacionet kryesore për heroinën dhe sasi shumë të vogla dërgohen në vende të tjera evropiane. Gjithnjë e më shumë, një pjesë e heroinës qëndron në Shqipëri për klientët lokalë. Viti 2007 shënoi një rritje të lehtë të çmimit të heroinës në nivel rruge, (21 deri 25 Euro për 1 gram), por gjatë vitit 2008 çmimi nuk u rrit më tej. Pastërtia tipike e heroinës në nivel rruge është 1 %.

Kokaina duket se vjen në Shqipëri kryesisht nga korrierët ose dërgesat me postë nga SHBA dhe/ose vendet e Amerikës së Jugut, tradicionalisht të njohura për prodhimin e saj. Fillimisht dërgohet në Itali dhe në Greqi, shpesh në sasi të vogla. Sipas Policisë së Shtetit:

- më 2005, ishin 6 raste të konfiskimit të kokainës; u kap 2,8 kg kokainë dhe 11 shkelës të ligjit u ndoqën penalisht;
- më 2006, ishin 8 raste të konfiskimit të kokainës; u kap 3,9 kg kokainë dhe 23 shkelës të ligjit u ndoqën penalisht;
- më 2007, ishin 15 raste të konfiskimit të kokainës; u kap 12,9 kg kokainë dhe 19 shkelës të ligjit u ndoqën penalisht.

Çmimi i 1 gram kokaine ishte 45 deri 65 Euro më 2007 dhe 50 deri 70 Euro më 2008.

Drogat sintetike nuk konsiderohen si problem në tregjet shqiptare të drogës, përse i përket qoftë furnizimit ashtu dhe kërkesës.

Ligjet kombëtare për drogën

Përse i përket legjislacionit ndërkombëtar, Shqipëria aderon në të tri Konventat e Kombeve të Bashkuara në lidhje me drogat.

Nenet 283, 284, 285 dhe 286 të Kodit Penal Shqiptar, përcaktojnë dënime të rënda për trafikimin, prodhimin, përgatitjen, shpërndarjen, transportin, mbajtjen dhe shitjen e drogave dhe substancave psikotropike (pa asnjë përjashtim), konkretisht 5–10 vjet burgim për prodhimin, shitjen, shpërndarjen dhe posedimin, dhe 7–15 vjet për trafikimin. Këto dënime janë më të rënda nëse krimi është kryer në bashkëpunim me ose nga organizata kriminale. Sanksione penale ekzistojnë gjithashtu për kultivimin e paligjshëm të bimëve narkotike (3–7 vjet burgim), dhe trafikimin ose përgatitjen e prekursorëve të drogave (3–7 vjet burgim). Posedimi i një 'doze ditore' droge për përdorim personal nuk është i ndëshkueshëm. Shumë shpesh, sasia e drogës së konfiskuar mund të ndikojë gjykatësin në marrjen e vendimit për dënimin minimal ose maksimal për veprën penale.

Kodit Penal ju bënë përmirësime të rëndësishme që nga viti 2004, sikurse janë ndryshimet lidhur me organizatat kriminale (neni 333) dhe grupet kriminale të strukturuar (neni 333/a). Ndyshime të rëndësishme ju bënë edhe Kodit Shqiptar të Proçedurës Penale në lidhje me llojet e hetimeve të veçanta që ndërmerren; kështu, prokurori ka të drejtë të lejojë përdorimin e mjeteve të ndryshme të hetimit si survejimi, interceptimet, ndalimin në rrugë, dërgesat e kontrolluara, operacionet sekrete, etj., të cilat, kanë treguar aktualisht se janë shumë të dobishme për zbulimin e rrjeteve kriminale të lidhura me trafikimin e drogave.

Ligji nr. 8750 dt. 26.04.2001 'Për parandalimin dhe luftimin e trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotropike', përcakton standardet për parandalimin dhe luftimin e trafikut të paligjshëm të drogave dhe lëndëve prekursorë për prodhimin e tyre. Ai lejon përdorimin e metodave të detajuara investigative siç është "blerja e simuluar", "dërgesat e kontrolluara", agjentët e "infiltruar" dhe "sekretë". Në këtë ligj është përcaktuar gjithashtu edhe krijimi dhe funksionimi i Komitetit Kombëtar për Koordinimin e Luftës kundër Drogave.

Ligji nr. 7975 dt. 26. 07.1995, 'Për substancat narkotike dhe psikotropike', i ndryshuar me Ligjin nr. 9271 dt. 9.09.2004 dhe Ligjin nr. 9559 dt. 8.07.2006, përcakton dënimet për prodhimin, paketimin, importin, eksportin, ndërmjetësimin, kontrollin dhe ruajtjen e drogave narkotike dhe substancave psikotrope.

Ligji nr. 8874 dt. 29.03.2002, 'Për kontrollin e lëndëve që mund të përdoren për prodhimin e paligjshëm të substancave narkotike dhe psikotrope', përcakton masat për kontrollin e lëndëve që shpesh përdoren për prodhimin e paligjshëm të substancave narkotike dhe psikotrope, me qëllim goditjen e furnizimit të tyre. Ligji përcakton gjithashtu dënimet për këto vepra penale.

Strategjia Kombëtare kundër Drogës

Gjatë vitit 2001, një grup teknik nga Ministria e Shëndetësisë, (konkretisht Instituti i Shëndetit Publik dhe Shërbimi i Toksikologjisë Klinike në QSUT), me mbështetjen teknike të ekspertëve çekë, (në kuadër të Projektit Phare, Republika Çeke dhe Shqipëria, Asistencë për Programin e Reduktimit të Kërkesës për Drogë), hartuan Strategjinë e parë Kombëtare për Reduktimin e Kërkesës për Drogë 2001–04, e cila u miratua nga Ministria e Shëndetësisë. Kjo Strategji u përfshi në Strategjinë e mëvonëshme Kombëtare kundër Drogave 2004–10, dhe përbën komponentin për reduktimin e kërkesës për drogë.

Në vitin 2004, një grup ndërministror pune, hartoi Strategjinë Kombëtare kundër Drogave 2004–10, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 292 dt. 7.05.2004. Strategjia është një dokument i plotë që përfshin reduktimin e kërkesës për drogë si dhe reduktimin e furnizimit të saj. Ajo ishte produkt i pjesëmarrjes së të gjitha institucioneve publike të përfshira në luftën kundër drogës, organizatave joqeveritare, si dhe mbështetjes së ekspertëve të organizatave ndërkombëtare që punojnë në Shqipëri.

Strategjia njeh natyrën serioze të problemit të drogës në nivel vendi dhe ndërkombëtar, dhe pranon se suksesi mund të arrihet vetëm duke koordinuar përpjekjet e të gjitha palëve aktive, konkretisht të qeverisë, shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë. Për ta bërë të zbatueshme këtë Strategji, Kryeministri i vendit, me Urdhërin e Kryeministrit nr. 156 dt. 23.09.2004 miratoi një plan veprimi shumë-sektorial, ku të gjithë institucionet/agjensitë/aktorët përkatës kanë marrë përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për periudhën 2004–10.

Megjithatë, komponenti i reduktimit të kërkesës për drogë ka mbetur i fragmentuar dhe i financuar në mënyrë të pamjaftueshme, ndërkohë që reduktimi i furnizimit me drogë dhe çeshtjet e zbatimit të ligjit përbëjnë një pjesë integrale të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe janë pjesë e prioritetëve të Qeverisë shqiptare. Për këtë arsye është e domosdoshme që të sigurohet që edhe reduktimi i kërkesës për drogë të fitojë të njëjtën rëndësi si politikë prioritare sikurse reduktimi i furnizimit me drogë.

Mekanizmi koordinues në fushën e drogave

Komiteti Kombëtar i Koordinimit për Luftën kundër Drogave, nën varësinë e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, u krijua më Ligjin nr. 8750 dt. 26.03.2001, 'Për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotropë', me synim që (a) të

zbatojë politika për parandalimin dhe kontrollin e drogave; (b) të organizojë zbatimin e masave për parandalimin dhe kontrollin e drogave; (c) të koordinojë veprimet e të gjitha institucioneve qeveritare dhe organizatave jofitimprurëse në fushën e parandalimit dhe kontrollit të drogës. Komiteti është mbledhur disa herë për të vlerësuar situatën e drogës në Shqipëri. Në zbatim të udhëzimeve të drejtuesit të tij, Kryeministrit të vendit, të lëshuara më 7.05.2003, Komiteti ngriti një grup ndërministror pune për të hartuar një strategji kombëtare afatgjatë kundër drogës dhe planin e veprimit për implementimin e saj, të cilat u hartuan dhe miratuan gjatë vitit 2004, siç u theksua më sipër në këtë raport.

Megjithatë, adresimi i çështjeve të mëposhteme, të parashtruara në rekomandimet e grupit të punës së Strategjisë Kombëtare kundër Drogave 2004–10 mbetet nevojë urgjente:

1. Komiteti duhet t'i kushtojë vëmendjen e duhur zbatimit adekuat të çështjeve që lidhen me reduktimin e kërkesës për drogë që janë pjesë e Strategjisë.
2. Duhet të freskohet zyrtarizimi i Qendrës Kombëtare për Sistemin e Informacionit për Drogën, pranë Institutit të Shëndetit Publik (krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 412 dt. 20.05.1996), me tërë atributet e saj për grumbullimin, analizen dhe diseminimin e të dhënave mbi kërkesën dhe furnizimin me drogë.
3. Duhet të krijohet një sekretariat pranë Komitetit të lartpërmendur Kombëtar të Koordinimit të Luftës kundër Drogave, si njësi administrative mbështetëse në fushën e drogës.

Kërkimet rreth drogës

Kërkimi shkencor është prioritet i Strategjisë Kombëtare për kontrollin, parandalimin dhe vartësinë nga droga, së bashku me zhvillimin e sistemeve të informacionit dhe trajnimet për studimin e fenomenit. Instituti i Shëndetit Publik, qendra kombëtare shkencore në fushën e shëndetit publik, luan rolin e liderit në (a) kërkimet epidemologjike të lidhura me drogën në popullatën përgjithshme dhe grupet specifike të saj; (b) zhvillimin e rekomandimeve metodologjike përkatëse; (c) grumbullimin dhe analizimin (përmes Qendrës Kombëtare për Sistemin e Informacionit për Drogën në varësi të tij) e të gjitha të dhënave të lidhura me drogën dhe kërkimeve në vazhdimësi nga institucionet/agjensitë/aktorët përkatës; (d) vlerësimin e efektivitetit të programeve parandaluese dhe të masave në nivel kombëtar; dhe (e) shpërndarjen e kërkimeve, rezultateve dhe informacioneve të lidhura me drogën.

Publikimet e mëposhtë-listuara në seksionin e Referencave ilustrojnë llojin e kërkimeve për drogën të realizuara në Shqipëri.

Referencat

Instituti i Shëndetit Publik, (ISHP) Shqipëria (2006), Studimi mbi Sjelljet e Rrezikshme të të Rinjve, 2005, Raport i ISHP, Tiranë, Shkurt.

Instituti i Shëndetit Publik, USAID, FHI dhe ISOP (2006), Shqipëria, Raporti i Studimit të Survejancës Biologjike dhe të Sjelljes, Family Health International, Tiranë.

Kakarriqi, E. (1996), 'Vështrim epidemiologjik për abuzimin me drogat në Shqipëri', Takimi i 25-të i Ekspertëve të Epidemiologjisë, Këshilli i Evropës, Pompidou Group, Strasbourg, 25–26 Nëntor, P-PG (97) 2.

Kakarriqi, E. (1999), Raporti Kombëtar i Shqipërisë në Parandalimin Paraprak të Drogave në Komunitet, Programi Phare TA to DDR (Asistencë Teknike për Reduktimin e Kërkesës për Drogë), Tetor.

Kakarriqi, E. (të ndryshme), Shqipëri: Pyetësorët e Raporteve Vjetore, pjesa II — abuzimi me drogat (shtrirja, modelet dhe prirjet e abuzimit me drogën), viti i raportimit 2003 (E/NR/2003/2), 2004 (E/NR/2004/2), 2005 (E/NR/2005/2), 2006 (E/NR/2006/2), 2007 (E/NR/2007/2), Pompidou Grup i Këshillit të Evropës, Strasbourg.

Kakarriqi, E., Sulaj, Z. (2000a), Shqipëria në DRSTP II, Pompidou Grup Projekti i Trainimit të Stafit për Reduktimin e Kërkesës për Drogë (DRSTP II), Strasbourg, 20 Mars 2000 (P-PG/Trainim (2000) 1), dhe 20 Shtator 2000 (P-PG/Trainim (2000) 2 rev).

Kakarriqi, E., Sulaj, Z. (2000b), Raporti kombëtar mbi situatën e drogës në Shqipëri, 2000, Projekti PHARE për Sistemet e Informacionit mbi Drogën, Faza ndërlidhëse, Komisioni Europian, Brussels.

Kakarriqi E., Sulaj, Z. (2001), 'Shqipëria', në studimin e tretë për disa qytete: Tendencat e përdorimit të drogës në qytetet evropiane në vitet 1990, Publikim i Këshillit të Evropës, Strasbourg, pp. 28–29.

Këshilli i Evropës (1996), 'Seminar për sistemet e informacionit dhe epidemiologjinë e aplikuar mbi abuzimin me drogat për ekspertët shqiptarë' (Tiranë, Hotel Rogner 'Europopark' 18–20 Dhjetor, 1995), Pompidou Group, Strasbourg, 5 Janar, P-PG (96) 1.

UNFPA (Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë) (2008), Mbështetje për stilet e shëndetshme të jetesës për të rinjtë në Shqipëri, Rapoti i Zyrës së UNFPA për Shqipërinë, Tiranë.

Light blue horizontal bar

Dark blue horizontal bar

Light blue horizontal bar

Dark blue horizontal bar

Light blue horizontal bar

Dark blue horizontal bar